



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 02/05/2024
PRIMLJENO:
02/05/2024

Nr. 02/_____
Datë: 29.04.2024

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -III- (tretë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Caktimi i lokacionit për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2023.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2024
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024.
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 13.03.2024 dhe filloi në ora: 09:45. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Gentianë Hoti, Arlindë Rudi, Hamit Lima përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -III- (tretë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi 7 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Nëse nuk ka diskutues shkojmë në votim. Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime të 7 anëtarëve votohet rendi i ditës.

Po vazhdojmë me pikën e dytë deri të vjen drejtoresha e arsimit për informata shtesë rreth pikës së parë. Pika e dytë e rendit të ditës është Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023. Duhet ta falenderojmë secilin Komitet që janë duke e vazhduar punën pa ndërprerë, përkundër faktit që ende nuk janë kryer pagesat për mbledhjet e tyre. Në këtë Raport është bërë një përshkrim i aktiviteteve, vizitave të tyre që i kanë pasur. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Faleminderit, Kryesues!

Është për tu vlerësuar puna e tyre dhe ne në momentin që i kemi themeluar këto trupa të Kuvendit komunal dhe i kemi dërguar përfaqësuesit tanë, e kemi pasur të qartë që kanë me na ndihmu neve si Kuvend me i dërgu para do qështje të cilat munden me na ik neve në punët e përditshme. Ky Komitet i ka pasur do vizita në QKMF-ë, në qendrën për punë sociale dhe në QMF familjare në Kijevë dhe i kanë evidentu disa raste. Unë nuk kam ndonjë vërejtje as për këta as për të tjera Komitete që me kerku më shumë prej tyre, për faktin që ne nuk jemi korrekt me ta me pagesa. Në fillim të mandatit e kemi marr një vendim i cili nuk është duke u zbatu, nuk e di cili autoritet është më i lartë se sa Kuvendi, vendimet e të cilit shkelen qdo ditë prej drejtorëve komunal këtu, në këtë rast nga drejtori i financave. Unë i kaloj të gjitha për hirë të punës së tyre përndryshe nuk e kisha dërguar asnjë në kuvend i kisha votu kundër. Nuk e di ku po thirret drejtori që nuk po i zbaton këto vendime. Është momenti i fundit që dhe ne si opozit por dhe ju si mazhurancë me thënë fjalën e juaj në kuvend që nuk kalon asnjë pikë e krytarit dhe asnjë vendim tjetër pa u zgjidh këto qështje. Mos ta detyrojmë dikën me e padit komunën në Gjykatë ose përmes përmbarusit privat, ose në tjetrën anë po i konvenon.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Edhe pse ne nuk ju kemi bashkangjitur herën e fundit që e keni bërë si lloj proteste, ne vazhdimisht e kemi thënë që duhet me u pagu dhe jemi munduar atë ndikimin, mirëpo ndoshta nuk varet e gjitha tek ne si asambleistë. Ndoshta do ishte mirë bashkarisht të ndërmarrim diqka, jo ndonjë protest mirëpo me gjetë një gjuhë të përbashkët dhe me u pagu këto Komisione.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Përshëndetje për të gjithë!

Unë prita që ky raport me pas të bashkangjitur dhe një raport për ambullanten publike sepse sa e di kanë qenë duke funksionuar, kanë qenë të punsuar si Teknik dhe me përfshi qfarë shërbime kryejnë ata. A e kanë sikur komunat e tjera që shkojnë i vizitojnë qdo javë fëmijët 1-3 vjeq, siq e ka Suhareka një herë në javë me i vizitu fëmijët e vegjël dhe me përcjellë gjendjen dhe të nënës lehonës dhe të fëmiut. Vizitën që e kanë bërë tek Hidroregjioni për ujë, mirë që janë interesu por pse nuk kanë cek asgjë në analiza, a është e lejshme ai ujë i pijes apo jo.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Hamit, ekipa që e ceke është fakt që ajo del në teren dhe kujdeset për fëmijët, gratë lehona dhe pleqtë këtë e kam vërtetuar nga kolegët e mia që kanë kaluar në këtë process dhe tani dhe vetë nuk kam pasur nevojë asnjëherë terapin me marr në ambulant por janë ardhur ekipa në momentin që unë jam lajmru aty. Kur t'i nuk shkon me u lajmru që je lehon dhe ke nevojë për ndihmën ata nuk munden me ditë. Në momentin që ti shkon dhe lajmrohesh ata vinë.

Hamit Lima: Kjo nëse është me u lajmru nuk po e shohë të arsyeshme pse me u lajmru. Nëse është kjo, ti duhet me pas një informacion me e shpërnda që duhet me u lajmru. Ne si asambleista nuk e dimë që duhet me u lajmru, e nëse ndodh kjo tek t'i kanë qenë, unë e di që me një vend nuk kanë qenë. Kjo është selektim ose është jo punë e mirë që nuk informojnë.

Gentianë Hoti: Nuk është selektim por duhet të shkohet të lajmrohet.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e Raportit të Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023?

Për: 6

Kundër: 1

Abstenim: 0

Po vazhdojmë me pikën e parë caktimi i lokacionit për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë. Bazuar në planifikimin për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë, i cili ndërtim financohet nga MASHT në bashkëpunim me komunën e Malishevës, kërkoj nga ana juaj që të bënë definimin e parcelës e cila do të dedikohet për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë dhe është vendosur të jetë në hapsirën e pronës publike ku është shkolla fillore e mesme e ulët "Ismail Qemali" dhe hapsirës përreth saj e cila është në pronësi publike. Definimi i parcelës kërkohet që të bëhet me qëllim të fillimit të ndërtimit të çerdhes së re për fëmijë në fshatin Bellanicë, e cila do të jetë në shërbim dhe të fshatrave në rrethinë. Pas definimit të parcelës dhe përcaktimit të saj kërkojm nga drejtoria përkatëse të bëjë propozimin për vendosjen e kufirit kadastral të parcelës dhe të nxjerrë fletën poseduese e cila duhet të aprovet përmes asambles komunale që parcela të kalojë në pronësi të çerdhes për fëmijë në fshatin Bellanicë. Urdhëro, drejtoreshë!

Arbëreshë Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Kjo pikë e ka rëndësinë e vetë dhe të veçantë që ka të bëjë me ndërtimin e një çerdhe të re për fëmijë në fshatin Bellanicë. Është për herë të parë Ministria e Arsimit e cila po përfshihet në investime të tilla, duke përjashtu shkollën e vjetër në Banjë, që është ataku në çerdhe dhe jemi në procedurat finale për çerdhen tjetër në shkollën e vjetër në Dragobil. Deri tash kemi pasur përvoja që Ministria e Arsimit e ka ndihmuar komunën e Malishevës sidomos me qështjen e çerdheve, por jo të reja. Na ka ndihmuar me çerdhen në Banjë, objekti i vjetër i shkollës për kthyer në çerdhe që shumë shpejtë dhe do të finalizohet puna e saj si çerdhe. Jemi në procedura të fundit dhe të çerdhes në Dragobil, gjithashtu gjitha kërkesat që janë kërku nga Ministria e Arsimit ne si drejtori i kemi plotësuar dhe kemi mbetur në finalizim që nënkupton që të gjitha projektet finale që kanë qenë kërkesë e komunës së Malishevës por dhe të gjitha komunave Ministria e Arsimit do ti bëjë publike me datën 15 mars.

Sa i përket çerdhes së Bellanicës ne si drejtori i kemi plotsuar të gjitha ato që kanë kërkuar nga Ministria vetëm ka mbetur caktimi i lokacionit për ndërtimin e çerdhes. Këtu e kemi parcelën e cila ka të bëjë me pronën publike, një pjesë është e shkollës dhe pjesa tjetër është pronë publike. Ju falenderoj shumë për bashkëpunimin!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Drejtoresh, na gëzon fakti që po bëhet dhe një çerdhe tjetër në Malishevë, nuk kam diqka kundër për lokacionin në fshatin Bellanicë, po nisëm vetëm nga fakti që tani është në procedurë të përfundimit në fshatin Banjë. Banja me Bellanicën smunden me qenë më shumë se 3km, ndoshta do ishte mirë me e bart në Dragobil. Por meqenëse qenka dhe në Dragobil në procedurë neve na mbetet me votu aty ku është. Nuk pash ndonjë informacion sa është investimi nga Ministria dhe sa do të jetë participimi si komunë, apo është e gjitha investim i Ministries. Përveq kësaj në Bellanicë dhe Dragobil a keni bërë kërkesë tjetër dhe për ndonjë vend tjetër sepse ka mbetur një pjesë që përfshin Carrallukën, Drenoc e deri te Balinca, a është trajtuar nga ju si drejtori dhe ky lokacion.

Ne si Kuvend e kemi marr një vendim që familjet që i kanë dy fëmijë në qerdhe, fëmija i dytë me u pagu 50% më pak. Sa kam informacion secili prind që i ka dy fëmijë është duke pagu pagesën qind për qind. Pse nuk po zbatohet ky vendim dhe a keni marr ndonjë hapë?

Arbëreshë Krasniqi: Drejtorja e Arsimit është më shumë se kurr e angazhuar rreth projekteve të reja në drejtim të përmirimit të infrastrukturës me objekte në Malishevë. Ne si drejtori kemi bërë kërkesa në katër objekte të vjetra për me i përkthi në çerdhe. Kërkesa e parë ka qenë shkolla e vjetër "Xhevë Krasniqi-Lladrovci në Drenoc, kërkesa e dytë ka qenë shkolla e vjetër "Imer Krasniqi" në Carrallukë, kërkesa tjetër ka qenë shkolla vjetër në Dragobil dhe shkolla e vjetër në Banjë. Ministria e Arsimit në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizmit kanë dalë dhe e kanë mat statikën e objekteve që ka rezultu që në Drenoc dhe në Carrallukë ka rezultu një statik e dobët të dy objekteve. Ministria e Arsimit nuk investon në objekte ku nuk ka siguri, ndërsa në Banjë dhe në Dragobil e kanë gjetë të kundërtën objektet e kanë një statik të qëndrueshme. Kërkesën për të cilën jemi duke e diskutuar për fshatin Bellanicë, ka rezultu nga matjet e sistemit smia. Një prej kërkesave të tjera për qerdhe të re është fshati Damanek, por ata e kanë vlerësuar nga numri i fëmijëve.

Çmimi përfshin mbi 250,000.00E, ne jemi duke negociu që ta merr përsipër gjithë investimin Ministria e Arsimit. Me kërkesën e fundit që e kemi bërë për shkak të kufizimit buxhetor të komunës së Malishevës dhe në pa përkrahje të qeveris në drejtim të buxhetit të komunës kemi kërkuar dhe kemi argumentu se do të duhet çerdhen ta investon Ministria e Arsimit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Çerdhja e Banjës dhe e Bellanicës qfarë kapaciteti kanë dhe nga sa fëmijë parashihen me qenë në këto dy çerdhe. Mos po ngarkohum shumë me çerdhe, në Dragobil, në

Banjë, në Bellanicë, Damanek, Drenoc plus kemi çerdhe privat dhe këto private mendoj që kanë me i marr perqimet dhe në komunë, sepse dhe shkollat janë mbetur me nga 9 nxënës në klas.

Arbëreshë Krasniqi: Hamit, mirë që këtë pyetje po e bënë këtu mirëpo të kisha rekomandu mos me bërë në asamble sepse nuk reflekton mirë.

Hamit Lima: Drejtoreshë, unë dhe me bërë këtë pyetje në asamble nuk po e kundërshtoj.

Arbëreshë Krasniqi: Janë diku 980 fëmijë në komunën e Malishevës të cilët orientohen në drejtim të parashkollores, që nënkupton përgjatë gjithë këtyre viteve shumë fëmijë nuk e kanë mundësin për me vijë çerdhen. Sipas kapaciteteve të fëmijëve dhe nevojave që ka komuna e Malishevës do të duhet në komunën tonë të jenë 12 çerdhe sepse edukimi hershëm sjellë bazament të sigurt për shkollim dhe mundësi edukative në të ardhmen. Të gjithë ne duhet me u bërë bashkë, sa më shumë çerdhe është më mirë për fëmijët dhe komunën e Malishevës.

Hamit Lima: Unë atë nuk e kontestova që nuk mundemi me qenë bashkë ose jemi kundër.

Arbëreshë Krasniqi: Fshati Banjë në gjendjen civile i kemi gjetur diku 50 lindje në vit të reja, që nënkupton të 50 kanë nevojë të shkojnë me u eduku në çerdhe. Vetëm Banja me kapacitetin që e ka e mbulon me fëmijët që do duhet të shkojnë në edukim të hershëm. Sa i përket vendimit për fëmijët që janë në çerdhe që fëmiju dytë të paguan 25 E, ne e kemi pritur ligjshmërinë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Unë dua ta falenderoj dhe DKA-në dhe drejtoreshën për gjithë angazhimin në gjitha këto çerdhe për një kohë kaq të shkurtër, ku u hapen dhe dy çerdhe të reja në Malishevë dhe ja ka lehtësuar dhe jetën nënave të reja që punojnë dhe kanë ku me i lënë fëmijët dhe me i eduku, ky ka qenë synimi ynë gjatë gjithë fushatës që e kemi bërë. Uroj mos të ndalen me kaq çerdhe por të ketë sa më shumë aq sa ka nevojë. Njëkohësisht me falenderu dhe Ministrinë e Arsimit që po na jep mbështetje kaq të madhe në realizimin e këtyre çerdheve.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për kuvend pikën e pare, caktimi i lokacionit për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë?

Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2023. Komiteti për Barazi Gjinore ka pasur disa ndryshime në udhëheqjen e këtij komiteti. Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Tek Ky Komitet, unë besoj që grat që janë këtu duke mos i përjashtu dhe gjininë mashkullore po bëjnë një punë shumë të mirë dhe i nderojnë grat nënat në çdo festë që e kanë dhe me këtë angazhim që e bëjnë jam shumë e kënaqur me punën që e bëjnë këtu. Tani që kryesuese është Fatime Lima me të vërtetë është një zonjë e nderuar, e cila ka një firm të vetën ku ka shumë gra të punsuara dhe kjo është një model i një femre që ka arritur me investu në

femra që sa më shumë me i punësu ato. Mendoj që prej të gjitha komiteteve që janë është më se e qëllume zj Lima që është kryesuese e këti komiteti. Uroj punë të mbarë dhe uroj që sa më shumë të ketë barazi gjinore dhe në komunën tonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë e ndaj mendimin e njejtë me Gentianën që është një prej komiteteve më të rëndësishme duke u nisur për faktin se ne si qytetar të kësaj komune shpesh ose përmes mediave ose përmes njerëzve që i kemi me bashkëvendas shohim raste të dhunës, diskriminim, pabarazi gjinore në formë të ndryshme të cilat realisht ndoshta si derë e vetme është zyra për barazi gjinore, komunikimi që mundën me i ngrit si shqetësime të tyre.

Sa i përket rekomandimeve që i kanë dhënë si Komitet, dy rekomandimet e fundit ne të tetën e kemi dhe në Statut, rekomandimi që Kuvendi komunal të shpallë qytetar nderi. Ndoshta është mirë me ja dhënë si vërejtje që këtë rekomandim me heq sepse është në Statut.

Rekomandimi i shtatë është Kuvendi komunal për të shqyrtuar mundësinë për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinjë. Unë sa herë që aprovohet buxheti vjetor i komunës një prej pikave kryesore që çdo herë e cekim e cila nuk ka gjetur mbështetje është që të pasurohet biblioteka jo vetëm e qytetit por dhe bibliotekat e tjera nëpër shkollat fillore dhe të mesme dhe të ndërtohet një objekt i ri bibliotekës së qytetit që don ndoshta kosto tjetër. Si rekomandim mirë që e kanë bërë mirëpo ndoshta është mirë si kërkesë me ja dërgu dhe kryetarit.

Aktivitetet bashkëpunimi me gra me barazin gjinore këto i shohë të përditshme që i bëjnë Si vërejtje kisha dhënë Komitetit që në Kuvend mos të vjen raport me rekomandimin e 8 sepse është në Statut.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend raportin e punës së Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2023. Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e 4 shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2023. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Në bazë të publikimit që i bënë zyra e informimit, ndoshta është krahas dy komiteteve obligative dhe krahas komitetit për arsim, është njëri më aktive sa e shohë në teren që mban mbledhje të rregullta dhe realisht i bënë disa aktivitete që lidhen me vlerat dhe kategorit e dalura nga lufta. Unë prapë qendroj pas asaj që e thash në fillim që unë i kaloj të gjitha për hirë të punës e bëjnë dhe realisht dhe këta e bëjnë një punë të jashtëzakonshme si komitet. Në një takim që e kam pasur me kryesuesin e këti komiteti këta e kanë një shqetësim për mos pagesën e anëtarëve të komitetit dhe realisht mu kanë lutur me e ngrit në kuvend qështjen e objektit veteranëve të cilën e kam ngritur sdi sa herë në cilën fazë është dhe pse nuk po funksionalizohet. Tani me vendimin që e kemi marr për rrënimin e sahat kullës, muzeu i luftës që është mendoj që duhet me bart. Ndoshta është mirë me pas dhe këta si vërejtje që me ardh rekomandim prej tyre që muzeu i luftës që ndodhet në sahat kullë, pas rrënimin që ka me ndodh të bartet qoftë përkohësisht në objektin e veteranëve.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për kuvend Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pike rekomandimet për kuvend.

Kalojmë në pikën e katërt shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2024. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë desha të shtoj vetëm një qështje. Meqë na si anëtarë të kuvendit komunal kemi bërë në vazhdimësi thirrje ne si opozit që të paktën në seanca të kuvendit me ardh drejtori i shëndetësisë sepse kemi ngritur shumë qështje me shëndetësinë. Nuk e di pse nuk ka ardhur në kuvend asnjëherë dhe unë sdi sa herë e kam bërë këtë pyetje. Ndoshta ata si komitet dhe përshkak të doktorit që është si kryesues i komitetit i kanë ato lidhjet e moqme, që qdo 3-4 muaj të na vizitoj në kuvend.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për kuvend Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2024?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024. Kush është për rekomandim për kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë te shqyrtimi i kërkesave. Liridon Morina kërkon ndihmë financiare për shërimin e djalit Alpit, i cili ka nevojë për shërim jashtë vendit. Kjo kërkesë ka mbetur si lëndë, përndryshe mjetet janë grumbulluar dhe trajtimi është kry. Kush është për refuzimin e kërkesës së Liridon Morina, me arsytimin që janë grumbulluar mjetet e nevojshme për trajtimin e Alpit?

Me vota unanime, kjo pikë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Shefqet Baftjar Mazreku nga fshati Guriq, i cili kërkon nga Kuvendi komunal që të miratoj kërkesën time rruga Miniera lagjaj Lahaj për kyqjen në kanalizim dhe sipas mundësisë buxhetore nga thesari i komunës të më ofrojn shumë financiare përrreth 150m kanalizim pasi që së shpejti do të vendosem në shtëpi të re dhe mundësit financiare janë teje në kufizuar për kryerjen vetanake për shtrirjen dhe kyqjen në kanalizim. Është një kërkesë që nëse e dërgojm në kuvend nuk ka si të trajtohet dhe tani nuk është muaji shtator që ne me vendos në projekt buxhet këto kërresa. Unë këtë kërkesë e rekomandoj për Drejtorin e Urbanizimit. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Drejtorin e Urbanizimit?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Drejtorinë e Urbanizimit.

Kërkesa tjetër është nga Vehbi Hoxha që fatkeqësisë ky ka ndërru jetë dhe që most ë jetë si lëndë në arkiv e sjella që ta refuzojm për shkak të vdekjes së personit. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet për shkak që personi ka ndërruar jetë?

Me vota unanime, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Avni Rudaj, i cili kërkon ndihmë për djali, për të cilin qdo një muaj ish i obligum të shkoj në Turqi për mos ti humb e pamura.

Kërkesa tjetër është nga Fadil Kastrati është me kancer.

Kërkesa tjetër është nga Rizah Berisha, ne banorët e lagjes së re kërkojm nga kryetari i komunës dhe kuvendit komunal që të na përkrah dhe mbështetë për tu kyqur në rrjetin elektrik pasi që KEDS na ka mundësuar kyqjen në rrjetin elektrik kompania e licencuar ka kërkuar shumë prej 13.000.00E shumë e cila është e pabërballueshme.

Rukije Bytyqi: Janë diku 20 familje.

Gentianë Hoti: Sipas informacioneve disa mjete i kanë grumbullar vetë

Hamit Lima: Është dhe një rast që shtëpia ju ka ndërtu nga Halil Kastrati dhe ka dhe shtëpi tjera që shkak rrymes nuk mund të del në shtëpi. Nëse kjo kërkesë kalon, të praktikohet kjo dhe për të tjerët.

Gentianë Hoti: Dhe kjo shtëpi është në atë lagje.

Argjend Thaçi: Ne po besoj se do ta mbështesim me një shumë simbolike.

Gentianë Hoti: 13,000.00E ata i kanë grumbulluar vetë dhe komunës i bie diku 2-3,000E me 1 ndihmu.

Argjend Thaçi: Kushë shtë që kërkesa nga Rizah Berisha të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet për kuvend.

A i rekomandojm këto tre raste për kuvend. Kush është që kërkesa nr 02/619, kërkesa 02/94 dhe kërkesa nr.02/466 të dërgohen për kuvend?

Me vota unanime këto kërkesa rekomandohen për kuvend.

Kërkesat tjera janë nga Sitrije Krasniqi, Feride Shala dhe Liridonë Morina. Këtyre rasteve po ju ndajm seciles nga 450E. Kush është për që këtyre kërkesave të ju ndahen nga 450 E për secilën?

Me vota unanime këtyre kërkesave ju ndahen nga 450E.

Kalojmë te pikat të ndryshme. Urdhëro, Gentianë Hoti.

Gentianë Hoti: Është bërë një kohë që jemi në kuvend dhe e kemi cekur shpeshëherë dhe ne këtu që është dashur me u marr pak me ndonjë organizim si kryesues, a kemi ndonjë drek ne si kuvend si asambleistë. Përveq këtyre llaptopëve asgjë tjetër nuk ke bërë për kuvend.

Veton Zogaj: Unë pajtohem me Gentianën, sepse ne asnjëherë nuk kemi organizu një dark të fundvitit, por mundemi të kemi dhe vizita të natyrave të ndryshme. Tani nuk ka viza dhe mundemi me udhtu dhe jashtë vendit jo me buxhet qdo herë të komunës, mundemi të bëjmë dhe me forma të ndryshme me ndonjë donacion të ndryshme. E mbështes si ide të Gentianës.

Kryesues seancat solemne thirren nga kuvend, dhe shumica e asambleistëve përfundojnë në fund

të sallës në këmbë. Unë me gjithë respektin dhe për njerëzit musafir, merri praktikat dhe nga kuvendet komunale tjera dhe nga Kuvendi i Republikës, deputetët, asambleistët ulen në vendin e tyre.

Argjend Thaçi: Veton, e gjitha kjo po rrjedh si pasojë e mungesës së asambleistëve, Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për prezencën.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:11:05.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

